



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK**

1. Miratohet fillimi i procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01, nr. 110-1203, dt. 16.6.2010.
2. Organizimi i konsultimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023, për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, konsultimi publik do të zgjasë 15 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-330/03-54447/24, më 26.4.2024

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Fehmi Kupa

